



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT GJENERAL/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA  
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

**Dokumenti Nr 21.0.1-2007-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT MBI PASQYRAT FINANCIARE TË  
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR 31 DHJETOR 2007**

**Prishtinë, Shtator .2008**

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Opinioni i auditimit
- VI. Qasja e auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit
  - 1. Pasqyrat Financiare.
  - 2. Kontrolli i brendshëm dhe auditimi i brendshëm
  - 3. Paraja e Gatshme
  - 4. Prokurimi.
  - 5. Avancat për udhëtime
  - 6. Paga dhe mëditje
  - 7. Menaxhimi i pasurisë

### **Anekset**

- I. Pasqyrat financiare të Kuvendin e Republikës së Kosovës -së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007.
- II. Komentet e entitetit dhe përgjigjet e Z.R.GJ-së në këto komente.

## **Lista e shkurtesave dhe fjalëve**

AGJ	Auditori Gjenerale
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
FKK	Fondi i Konsoliduar i Kosovës

## **I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Zyra e Auditorit Gjeneral ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRK-së), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007.

Ne nuk kemi mundur të japim opinionin tonë lidhur me atë nëse pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007 paraqesin gjendjen e drejtë dhe të vërtetë, pasi që nuk kemi arritur të marrim dëshmi të mjaftueshme përkatëse të auditimit për të vërtetuar vlerën e pasurive të KRK-së dhe të gjeturat e tjera të hollësishme në pjesën e shtatë të këtij raporti.

Mohim i opinionit do të jepet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit në fushëveprim është aq material dhe i përhapur sa që ZAGJ nuk ka mundur të siguroj dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rrjedhimisht nuk mund të lëshoj opinion lidhur me pasqyrat financiare. Auditimi ynë i pasqyrave financiare të KRK –së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe përfshinë testimet dhe procedurat e tilla që ne i kemi konsideruar të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Ky auditim jep rekomandime të cilat përfshijnë shtatë kategori që duhet të drejtohen menjëherë nga menaxhmenti i KRK-së:

- 1. Pasqyrat financiare;**
- 2. Kontrolli i brendshëm**
- 3. Paraja e gatshme**
- 4. Prokurimi;**
- 5. Avancet për udhëtime jashtë vendit**
- 6. Paga dhe mëditje**
- 7. Menaxhimi i pasurisë**

## **II. HYRJE**

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/18 e datës 04 tetor 2002, krijon bazën ligjore për Zyrën e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) të Kosovës. Sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje, Auditori Gjeneral (AGJ) kërkohet që të kryej auditimin vjetor të rregullësisë për të gjitha institucionet e Kosovës qoftë për ato në pronësi publike apo për ato që marrin mjete financiare në Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendë, apo të hyra të tjera jo tatimore për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Neni 1 i kësaj rregulloreje përkufizon auditimin e rregullësisë si verifikim i përgjegjësisë financiare duke përfshirë ekzaminim dhe evlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe shprehjeve e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të drejtë dhe korrekte të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat, sistemet dhe transaksionet financiare janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme dhe funksioneve të auditit të brendshëm;
- Ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të nxjerra nga institucioni ose entiteti që i është nënshtruar auditimit; si dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat rrjedhin nga auditimi ose kanë të bëjnë me të.

Në muajin mars të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës ka miratuar “Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” Nr. 2003/2 (LMFPP), i cili edhe formalisht është shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/17 të datës 12 maj 2003. Neni 42 i këtij ligji thekson që AGJ duhet të përgatisë dhe t’i dorëzoj Kuvendit dhe PSSP-së një raport lidhur me pasqyrat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar, ku AGJ jep opinionin e saj nëse pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të financave të organizatave të tilla buxhetore.

## **III. GJENDJA NE LIDHJE ME REKOMANDIMET E VITIT TE KALUAR**

Auditimi i ZAGJ-së mbi pasqyrat financiare të KRK-se për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2006 kishte rezultuar me 22 rekomandime të auditimit. Auditimi ynë i tanishëm ka përcaktuar që KRK-së ka zbatuar 19 nga këto ndërsa tri prej tyre nuk janë implementuar. Këto tri rekomandime janë përfshirë me rekomandimet e këtij viti. Ne kemi kënaqësinë të raportojmë që zbatimi i gati të gjitha rekomandimeve jep një dëshmi të fortë të gatishmërisë së menaxhimit për t’i njohur dobësitë e raportuara dhe për të ndërmarrë masa për përmirësimin e nivelit të kontrollit të brendshëm.

#### **IV. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT**

ZAGJ ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007.

Objektivë primare e këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAGJ-së të shprehë opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të paraqitura në aneksin 1, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për të gjitha shpenzimet e bëra gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2007, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) mbi "Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". SNKSP-të janë nxjerr nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (BSNASP) i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK). Saktësia dhe plotësia e pasqyrave financiare si dhe shkresat shoqëruese të dhëna në aneksin 1, janë përgjegjësi e menaxhmentit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### **V. OPINIONI I AUDITIMIT**

Auditimi ka identifikuar mangësi në kontrollet e brendshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ka përcaktuar se nuk mund të mbështetemi në këto kontrolle. Dobësitë kryesore të kontrollit të brendshëm dhe rastet e mos-zbatimit të ligjit janë diskutuar në Pjesën VII të këtij raporti. Krejt në fund, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në pajtim me SNKSP-të dhe UA 2007/08 raportim vjetor i Organizatave Buxhetore. Shmangie të theksuara nga SNKSP-të përfshinin:

- Sistemi joefikas i kontrollit të brendshëm dhe
- Mungesa e procedurave të kontrollit: në prokurim, në menaxhimin e pasurisë, avanse .

#### **VI. QASJA E AUDITIMIT**

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007 është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të hartuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. Bordi funksionon si një organ përcaktues për standardet ndërkombëtare, nën patronazhin e FNK-së. SNA-të vendosin kornizën ndërkombëtare në kuadër të cilës ZAGJ kryen aktivitetin e saj dhe mbulon çështje si parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve si dhe konkluzionet dhe raportimi mbi auditimin.

Auditimi ynë ishte planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 03.03.2008 deri më 14.05.2008. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona, ne:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Kuvendit të Kosovës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë përgatitur në pajtim me SNKSP-të “ Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
- Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë .

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka të ngjarë që informata shtesë mund të kenë ekzistuar, të cilat nuk na janë siguruar neve, të cilat po të na siguroheshin do të kishin mundur të ndryshonin të gjeturat tona të auditimit për sa i përket opinionit të auditimit të ZAGJ-së lidhur me pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

SNA definojnë kriteret specifike të cilat përcaktojnë llojin e opinionit i cili mund të ipet.

Opinionit i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit. Për shembull, ZAGJ mund të mos jetë në gjendje të japë një opinion të pakualifikuar kur ekzistojnë cilado prej rrethanave vijuese dhe sipas gjykimit të ZAGJ-së efekti i çështjes është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

- (a) Kur ka kufizim të fushëveprimit të punës së auditorit; ose
- (b) Kur ka mosmarrëveshje me menaxhmentin lidhur me pranushmerinë e politikave të zgjedhura kontabël, metodën e aplikimit të tyre ose përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare.

Rrethanat e përshkruara nën (a) mund të shpijnë në opinionin e kualifikuar ose në mohimin e opinionit. Rrethanat e përshkruara nën (b) mund të shpijnë në opinionin e kualifikuar ose në opinionin kundërt.

Një opinion i kualifikuar në përgjithësi lëshohet atëherë kur ZAGJ konstaton se nuk mund të jepet një opinion i pakualifikuar, porse efekti i ndonjë mosmarrëveshjeve me menaxhmentin ose kufizimi i fushëveprimit nuk është aq material dhe i përhapur sa të kërkojë dhënien e një opinionit të kundërt ose mohim të opinionit.

Mohim i opinionit do të jepet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit në fushëveprim është aq material dhe i përhapur sa që ZAGJ nuk ka mundur të siguroj dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rrjedhimisht nuk mund të lëshoj opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Një opinion i kundërt do të jepet atëherë kur efekti i mosmarrëveshjes është aq material dhe i përhapur në pasqyrat financiare për çka dhe ZAGJ konstaton se kualifikimi i raportit nuk është i përshtatshëm për të shpalosur natyrën e çorientuar ose jo të plotë të pasqyrave financiare.

## **VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KYCE**

Në vijim janë të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të cilat rezultojnë nga auditimi ynë i pasqyrave financiare të KRK-së për vitin e përfunduar 2007.

### **1. Pasqyrat financiare**

Pasqyrat financiare duhet të përgatiten nga çdo entitet i pavarur në bazë të shënimeve vetanake të kontabilitetit dhe në atë mënyrë që pasqyrat financiare të tregojnë përgjegjësinë dhe transparencën në shfrytëzimin e parasë publike. Formati i tyre kërkon shpalosje të tjera me informata që duhet ofruar shfrytëzuesve.

Paraqitja dhe shpalosja e informatave duhet të jetë në pajtim me kërkesat e specifikuar në Udhëzimin Administrativ 2007/08 i nxjerrë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.

Ligji nr.2003/2 “Menagjimi i Financave Publike dhe Përgjegjesitë” rregullon përgaditjen dhe harmonizimin e pasqyrave financiare për të gjitha organizatat buxhetore.

Për të qenë në pajtim me Ligjin nr.2003/2 kërkohet që:

- Zyrtari kryesor financiar i organizatës buxhetore brenda 30 ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal do t’ia dorëzojë drejtorit të Thesarit (i) kopjen e pasqyrave financiare (ii) konfirmimin që pasqyrat financiare paraqesin drejtë dhe saktë financat dhe transaksionet financiare të vitit.
- Drejtori i Thesarit brenda 90 ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal do të (i) harmonizojë llogaritë financiare me llogaritë fiskale dhe bilancet e parave të gatshme dhe (ii) dorëzojë llogaritë financiare për të gjitha organizatat buxhetore tek Auditori Gjeneral për auditim.

Këto pasqyra financiare duhet të përgatiten sipas shënimeve të kontabilitetit që duhet të mbahen nga çdo organizatë buxhetore siç është përkufizuar me Ligjin nr.2003/2 si në vijim:

- Arkëtimet e organizatës buxhetore
- Detyrimet e papaguara të organizatës buxhetore
- Pasuritë e organizatës buxhetore
- Ndarjet buxhetore
- Rregullimet e ndarjeve buxhetore
- Ndarjet që janë vënë në dispozicion për organizatën buxhetore për shpenzim përmes njoftimeve për alokimin e mjeteve



- Niveli në të cilin mjetet e alokuara të organizatës buxhetore janë regjistruar si mjete të zotuara
- Shpenzimet tashmë të realizuara.

Departamentit të Administratës e ka sektorin e kontabilitetit i cili është përgjegjës për raportimin financiar. Në këtë departament të gjitha transaksionet janë të përpunuara përmes sistemit vetanak të kontabilitetit. Megjithatë, ne kemi vërejtur që pasqyrat financiare janë bazuar në të dhënat e Sistemit “Free Balance” të Thesarit.

## **Të gjeturat**

KRK- nuk ka sistem të kontabilitetit i cili i regjistron të gjitha transaksionet dhe për këtë arsye mbështet në Sistemin “Free Balance” të Thesarit.

Në mungesë të një sistemit të pavarur të kontabilitetit nuk mund të ketë siguri që të gjitha transaksionet financiare janë regjistruar duke bartur me vete rrezikun potencial të një raportimi jo të plotë të informatave financiare.

## **Konkluzioni**

Meqenëse KRK-së i ka përgatitur pasqyrat financiare sipas SNKSP në bazë të shënimeve të Thesarit ne nuk mund të konfirmojmë plotësinë dhe saktësinë e tyre. Si pasojë, pasqyrat financiare mund të kenë mangësi dhe deklarime materiale të gabueshme.

## **Rekomandim**

1.1 KRK-së të filloj procesin e përgatitjes së politikave dhe procedurave formale për tu zbatuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiar dhe të mundësojë harmonizimet mujore me sistemin “Free Balance” të Thesarit.

1.2 KRK-së duhet ta merr parasysh blerjen e një programi përkatës të kontabilitetit për të regjistruar të gjitha transaksionet financiare. Kjo do të rriste efikasitetin e punës dhe do ta përforconte kontrollin e brendshëm.

## **2. Kontrolli i brendshëm dhe auditimi i brendshëm**

Një prej objektivave të auditimit është të përcaktohet përshtatshmëria e kontrollit të brendshëm dhe funksionit të auditimit të brendshëm në kuadër të KRK-së dhe se ne tashmë kemi raportuar fushat të cilat duhet të përmirësohen.

Si pjesë e auditimit tonë ne kemi përcaktuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njësinë së auditimit në KRK për të vërtetuar nëse puna e kësaj njësie mund të shërbej si mbështetje për qëllime të auditimit.

Sistemi i kontrolles së brendshme në sektorin publik bazohet në konceptin që kontrollet duhet të ekzistojnë në të gjitha aktivitetet e organizatës ashtu që objektivat të jenë përmbushur dhe shfrytëzimi më i mirë i burimeve është realizuar. Menxhmenti është përgjegjës për të siguruar që kontrollet e brendshme janë efektive dhe ofrojnë siguri të arsyeshme. Roli i auditimit të

brendshëm është rishikimi i efektivitetit të sistemeve kryesore të kontrollit të brendshëm dhe të jap këshillë dhe rekomandime se si dhe ku duhet të përmirësohen kontrollet.

## **Të gjeturat**

Gjatë auditimit tonë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2007, kemi hasur në një sistem të dobët të kontrolles së brendshme, të paraqitur si më poshtë:

- Auditori i brendshëm është emëruar me vonesë, data e lidhjes së Kontratës ka qenë me 01.08.2007, Gjatë auditimit tonë nga ana e Kuvendit na është ofruar Plani i Auditimit të Brendshëm, por për shkak të afatit të shkurt kohor ky plan nuk është realizuar në tërësi. Auditori i brendshëm na i ka ofruar vetëm dy Raporte të Auditimit të cilat kanë të bëjnë më Auditimin e Parasë së Imët si dhe më avancet për vitin 2007, por kanë mbetur pa u audituar :
  1. Menaxhimi i Buxhetit
  2. Procedurat e Prokurimit
  3. Procedurat e Pagesave
  4. Dosjet e Personelit
- Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e ka themeluar komisionin e auditimit, si parashihet me nenin 5.1 te Ligjit mbi Auditimin e brendshëm, më të cilin kërkohet që Auditori i Brendshëm ti përgjigjet komisionit të Auditimit, për shkak të mos themelimit të këtij Komisioni Njësia e Auditimit të Brendshëm i raporton Sekretarit të Përhershëm.
- Mungesa e procedurave te kontrollit në sfera kyçe të Kuvendit: në prokurim; menaxhimin e pasurisë; ndërrimi i shpeshte i stafit etj.

## **Konkluzion**

Kontrolli i dobët i brendshëm rrit rreziqet dhe mundëson paraqitjen e dukurive negative, si janë keqpërdorimet dhe mashtrimet e ndryshme.

## **Rekomandim**

Të formohet Komisioni i Auditimit dhe të njëjtit ti raportoj Njesisë së auditimit të brendshëm si mekanizëm mbështetës për udhëheqjen e entitetin si tërësi ,si dhe për përmirësimin e proceseve të menaxhimit të rrezikut.

Të forcoje procedurat e kontrollit në te gjitha sferat , si një komponentë shumë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm, për parandalimin dhe zbulimin e gabimeve dhe mashtrimeve.

## **3. Paranë e Gatshme**

Paraja e gatshme mund të jetë shumë lehtë subjekt mashtrimi dhe shpërdorimi. Duhet të instalohen kontrolla të përshtatshme për të limituar shumën e parasë së gatshme, për të siguruar që pagesat e bëra me para të gatshme të jenë në përputhshmëri më procedurat me të cilat

rregullohet mënyra e shfrytëzimit të parave të gatshme në para të gatshme janë kryer pagesat që kanë tejkaluar limitin individual; dhe në mënyrë arbitrare kanë ndarë pagesat për t'i pasur ato në kuadër të limiteve të kërkuara për pagesë me para të gatshme, gjithashtu më para të gatshme janë bërë blerje të cilat parashihen të realizohen përmes procesit të rregullt të shpenzimeve. Më poshtë janë dhënë rastet e identifikuara të metave të zbuluara gjatë auditimit:

## **Të gjeturat**

- Në gjashtë raste të shpenzimeve me para te imta në shumë prej 564.71 është bërë pagesa për shpenzimet për të cilat ka ekzistuar kontrata, edhe pse në nenin 9.3 të rregulla financiare dhe udhëzimeve të thesarit – 02 shpenzimi i parave publike përcakton se paraja e imët (Petty Cash) nuk bëne të përdoret për shpenzime të cilat bëhen përmes procesit të rregullt të shpenzimeve.
- Në dy raste në shumë prej 290€ pagesat individuale me para të gatshme zakonisht tejkalonin limitin prej 100 euro të vendosur nga rregulla financiare dhe udhëzimeve të thesarit – 02 shpenzimi i parave publike, që është shuma maksimale e lejuar. Për shembull, Shpenzimi për taksa dhe viza ne shumë prej 140 euro Shpallja në gazetën “Jedinstvo” për konkurs , ku kanë tërheqë avanc 150 euro, ku edhe pse kemi kërkesën dhe lejimin për këtë avanc.

## Konkluzion

Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka pasur kontrolla të brendshme adekuate për sa i përket parasë së gatshme,. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk iu ka përmbajtur rregulloreve të Thesarit që kanë të bëjnë me vendosjen e limitit për shumën maksimale të parasë së gatshme që mund të përdoret për transaksione me para të gatshme si dhe për qëllimin e përdorimit të parasë së imtë.

## Rekomandimi Nr. 3

Në mënyrë që të përmirësohen kontrollet mbi paranë së gatshme, ne rekomandojmë që Kuvendi i Republikës së Kosovës të:

- 3.1 Vendosë politika dhe procedura të shkruara që rregullojnë përdorimin e fondit të parasë së gatshme, të cilat do të specifikonin çështjet si; për çfarë mund të përdoret paraja e gatshme.
- 3.2 Kryej një analizë të këtyre nevojave ditore për para të gatshme dhe në këtë kuptim të vendos maksimumin e kufirit ditor

## **4. Prokurimi**

Gjatë vitit 2007, Kuvendi i Republikës se Kosovës ka bërë prokurime që gjithsej arrijnë shumë prej 412,904.47€ . Në bazë të gjykimit kemi përzgjedhur për rishikim një mostër prej 19 prokurimesh që gjithsej arrijnë shumë prej afërsisht 238,020 eurosh. Skica në vijim përmbledh rezultatet e rishikimit tonë dhe tregon se të gjitha veprimet e rishikuara të prokurimit kishin të paktën një mangësi apo shkelje të rregulloreve të prokurimit, ndërsa disa prej tyre kishin shkelje të shumëfishta. Që ta ilustrojmë:

## Të gjeturat

- Në gjashte prokurime që arrijnë gjithsej shumën prej 17,179.64 Kuvendi nuk i ka informuar operatorët ekonomik të cilët janë eliminuar nga procesi i tenderimit edhe pse një gjë e tillë kërkohet në baze të nenit 52 të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 02-L99 ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/20 në të cilën ceket që kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt.
- Në dhjete prokurime që arrin shumën prej 54,893.06 euro Kuvendi i Republikës së Kosovës ka bërë ndarjen e prokurimeve për ti ikur procedurave të hapura edhe pse në neni 17.5 të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/3, specifikohet se Autoriteti kontraktues nuk do të bëjë ndarjen e punëve ose kontratës së punëve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së punës ose të kontratës së punëve nën kufirin e caktuar në nenin 18.
- Në katër veprime të prokurimit që gjithsej arrijnë shumën prej 10,923.91€, Anëtarët e komisionit të emëruar për vlerësim të ofertave nuk e kanë nënshkruar deklaratën Nen Betim edhe pse në nenin 1 dhe 10 të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 02-L99 ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/20 në të cilin specifikohet se anëtarët e komisionit për vlerësim të ofertave e nënshkruajnë deklaratën Nen Betim me të cilën deklarohen se do të mbrojnë nga zbulimi dhe përndryshe do të ruaj konfidencialitetin e informacioneve afariste; gjithashtu, pranojnë që personalisht mund të konsiderohen përgjegjës nga aspekti penal dhe/ose civil për shpалosjen e informatave të tilla të bërë me qëllim ose për shkak të pakujdesisë.
- Në dy raste që arrin shumën prej 4,845.02 Autoriteti kontraktues nuk ka mbajtur procesverbal në lidhje me vlerësimin e kuotimeve të çmimeve edhe pse neni 2.8 i Udhëzimit Administrativ për blerjet me vlerë minimale i nxjerr nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në të cilin përcaktohet se pas vlerësimit të kuotimeve të çmimeve autoriteti kontraktues do të përpiloj Procesverbalin.
- Në dy prokurime që arrin shumën prej 4,845.02, Autoriteti kontraktues nuk i ka specifikuar në Urdhërblerja artikujt me të cilët është furnizuar nga operatorit ekonomik edhe pse neni 7.2 i Rregulla dhe Udhëzimeve të thesarit -02 Shpenzimi i parave publike specifikon se Zyra për Buxhet dhe financa, duhet të marrë raportin e pranimit që tregon që janë përfunduar (pranuar) mallrat/shërbimet në pajtim me kontratën. .
- Në dy prokurime që arrin shumën prej 2,216.40 Kuvendi në dosjen për kuotim të çmimeve me vlerë të vogël nuk e ka kërkuar nga Operatorët Ekonomik vërtetimin për pagesën e tatimit edhe pse në nenin 61.3 pika i) të Ligjit për Prokurim Publik nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/03, ceket se Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike,

nëse aktualisht është me vonesë për pagimin e tatimeve në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik.

- Në katër prokurime që gjithsej arrijnë shumën e afro 23,078.99 € Urdhërblertjet janë përgatitur dhe i janë dërguar Operatoreve Ekonomik mbasi janë pranuar faturat, edhe pse Rregulla dhe Udhëzimet e thesarit 02 Shpenzimi i Parave Publike përcakton se Urdhërblertja krijohet dhe përgatitet nga ana e organizatës buxhetore, pas procesit të selektimit të tenderëve, për të hyrë në marrëdhënie juridike me furnizuesin e suksesshëm.
- Në dy prokurime në shume prej 3,080.40 euro kemi gjetur që nuk kanë qenë tri oferta të përgjegjshme për shkak se operatorët ekonomik nuk e kanë ofruar dëshminë e pagesës së energjisë elektrike të shpenzuar ose kontrata me Korporatën Energjetike të Kosovës për pagesën e energjisë elektrike. Edhe pse në dosjen e tenderit kërkohet një gjë e tillë. Sipas dosjes, mos dorëzimi i dëshmive për pagesën e energjisë elektrike të shpenzuar mund të rezultojë me diskualifikimin e operatorit ekonomik përkatës nga procesi i ofertimit. Në këto rast dy ofertues nuk i kanë sjelle faturat e pagesës së energjisë elektrike, edhe pse neni 35.8 i Ligjit për Prokurim Publik nr. 02-L99 ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/20 përcakton se nëse, në një aktivitet të prokurimit që ushtrohet sipas nenit 35.1, më pak se tre (3) operatorë ekonomik që rregullisht i ofrojnë mallrat ose shërbimet përkatëse në treg dorëzojnë kuotime të përgjegjshme të çmimeve më shkrim në apo para afatit të fundit kohor të specifikuar në kërkesën për dorëzimin e kuotimeve të çmimit, autoriteti kontraktues do të anulohet aktivitetin e prokurimit.

## Konkluzion

Kontrollet e brendshme joadekuate dhe mos respektimi i ligjit të prokurimit sa i përket zbatimit të procedurave të prokurimit kanë për pasoje shpenzimin e pakontrolluar të parasë publike, duke rritur me këtë rreziqet e mashtrimit, shpërdorimit dhe keqpërdorimit.

## Rekomandimi:

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kontrolle të brendshme joadekuate mbi procesin e saj të prokurimit . Me qëllim të forcimit të kontrolleve të brendshme të tyre dhe për të siguruar prokurim më të mirë, në pajtim me ligjet e aplikueshme të prokurimit rekomandojmë që Kuvendi i Republikës së Kosovës:

- 4.1 Në mënyrë specifike si ceket në Ligjin e Prokurimit Publik të bëjë njoftimin e tenderuesve të eliminuar.
- 4.2 Të zhvillojë politika dhe procedura që do të garantojnë që veprimet e prokurimit të mos ndahen qëllimisht në mënyrë që të shmangët procesi konkurrues i tenderimit.
- 4.3 Të zhvillojë politika dhe procedura që garantojnë që anëtarët e komisionit për vlerësim të ofertave ta nënshkruajnë deklaratën nen betim.
- 4.4 Të zhvillojë politika dhe procedura për të garantuar që çdo here mbas vlerësimit të ofertave Kuvendi i Republikës së Kosovës të përgatitë procesverbalin e vlerësimit.

4.5 Të specifikohen në mënyre të plote në urdhërblertje mallrat me të cilat Kuvendi i Republikës së Kosovës parasheh të furnizohet .

4.6 Të zhvilloje politika dhe procedura që dosja e tenderit të përgatitet në përputhshmëri me Ligjin e Prokurimit Publik.

4.7 Të zbatohet politikat dhe procedurat adekuate për të garantuar faturat të pranohen mbasi të bëhet pranimi i mallrave ashtu siç përcaktohet me Rregulla dhe Udhëzimet e thesarit 02 Shpenzimi i Parave Publike.

4.8 Të zbatohet politika dhe procedura që procesi i tenderimit të zhvillohet vetëm mbasi të dorëzohen se paku tri oferta të përgjegjshme.

## **5. Avanset për udhëtime**

### **E gjetura**

Prej tetë mostrave të avanseve të zgjedhura për udhëtime jashtë vendit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2007, një prej tyre nuk është mbyllur, vlera e të cilit arrin shumë prej 10,000 euro siç është rasti i avansit për udhëtim në Belgjike dhe Francë ku ky depozitë i këtij avanci është bërë me 46 dite vonës.

Të gjitha shpenzimet e parave publike që lidhen me udhëtime jashtë vendit duhet të bëhen me rregulla financiare dhe udhëzimeve të thesarit 02 shpenzimi i parave publike në të cilën ceket se të gjitha avancet duhet të mbyllën brenda dy javë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Konkluzioni:

Ky zë i paqartë mund të tregojë për kontrollet e brendshme si të dobëta lidhur me këtë lloj të shpenzimit dhe rritë rrezikun e ekspozimit ndaj mashtrimit, shpërdorimit dhe keqpërdorimit.

Rekomandim:

Të gjitha avancat duhet të mbyllën dhe të shtohen kontrollet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që shumatat e pasqepnuara duhet të kthehen dhe këto mjete të derdhen në FKK si parashihet me rregulloret në fuqi.

## **6. Paga dhe mëditje**

### **E gjetura**

Kuvendi ka nxjerr vendimin nr. 02-2841-3/06 te datës 14.02.2007, për paga dhe kompensime pa pasur mbështetje ligjore, për shkak se si baze për nxjerrjen e këtij vendimi kane përmendur kreun 9.1.28 te Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 6.8 te Rregullores se Punës te Kuvendit, ndërsa kreu 9.1.28 i Kornizës Kushtetuese në asnjë pike nuk përcakton se Kryesia e Kuvendit ka te drejt te nxjerr vendime për paga dhe shtesa, po ashtu edhe Rregullorja e punës nuk mund te jete baze për nxjerrjen e vendimeve në lidhje me pagat, duke e ditur se Rregullorja e Punës e rregullon vetëm mënyrën e funksionimit te kuvendit.

Konkluzion:

Nxjerrja e vendimeve pa u mbështetur në bazën ligjore krijon mundësi të keqpërdorimit të mjeteve publike.

Rekomandim:

Të krijohen politika dhe procedura që vendimet e nxjerra të jenë në pajtueshmëri me bazën ligjore

## **7. Menaxhimi i pasurisë**

Gjate auditimit tone në Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2007 kemi vërejtur se Kuvendi shume pak e ka zbatuar Instruksionin Administrativ 2005/11-Për menaxhimin dhe Regjistrimin e Pasurive Qeveritare. Me këtë Kuvendi nuk ka njohuri mbi gjendjen e pasurive kapitale dhe jokapitale të saja, kjo ka ndikim direkt në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare të Kuvendit për vitin 2007.

### **Të gjeturat**

- Disa pasuri të trupëzuara nuk ishin regjistruar në regjistrat kontabël të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për shembull, ndërtesa e kryesore e Kuvendit si qendra protokollare në Germi automjeti me Nr. Serik WDB2030351F262931 vlere e automjetit është 19,763 Document imagine and Archiving system ne vlere prej 15,340. Ne regjistrin kontabël edhe pse me nenin 8 të Instruksionit Administrativ 2005/11 përcakton se të gjitha pasuritë kapitale që i mban Organizata Buxhetore në datën kur ky Instruksion Administrativ hyn në fuqi duhet të identifikohen dhe vlerësohen duke përdorur bazën e duhur të kostos. Komisioni për vlerësim të pasurive në organizatën buxhetore duhet të marrë në konsiderim arsyeshmërinë dhe materialitetin në qasjen e tyre .
- Kuvendi i Kosovës nuk e ka mbajtur një regjistër të sakte me vlerat e pasurive të cilat i ka në posedim, për shkak se shumicës se pasurive ju mungon vlere fillestare ose e vlerësuar. Edhe pse neni 3.7 pika i) i Instruksionit Administrativ 2005/11 Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive Qeveritare përcaktohen se Organizata Buxhetore është e obliguar të themeloje një regjistër te pasurisë, ku nder të tjera duhet që pasurinë ta regjistroj në vlerën fillestare apo të vlerësuar.

- Kuvendi i Kosovës nuk disponon me informacioni mbi vendndodhjen e një pajisje të teknologjisë informative një kompjuteri si dhe pajisjes së sigurimit. Siç është rasti me arkivuesin elektronik vlera e të cilit është 15,340 i blere me date 17.02.2002, si dhe një kompjuteri Pentium III 256mb me numër serik 10111200050 i blere me date 11.12.2001 në vlere prej 1,496.7, sigurimin e objektit të blera me date 26.05.2005 në vlere 5,466.99 si dhe nuk disponojnë me informata se cilët persona kane qene të ngarkuar me këto pajisje.
- Mos kryerja e inventarizimit të parapare me ligj ne Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2007. Në përputhje me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Organizata Buxhetore është e obliguar që një herë në vit në përfundim të çdo viti fiskal të bëjë njehsimin fizik apo inventarizimin e të gjitha pasurive që janë në posedimin e saj. Të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat përcaktohen pas inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

#### Konkluzion:

Mungesa e regjistrin gjithë përfshirës dhe saktë të pasurive e bën të pamundur që me saktësi të vlerësohet vlera e pasurive të KKK-së , rrit rrezikun e keqpërdorimit të pasurive . Përveç kësaj , kjo e bëne ma të vështirë për KKK-së monitorimin dhe shpërndarjen e burimeve të saja nëpër departamente të ndryshme buxhetore në mënyrën e duhur.

#### Rekomandim:

- a) Menjëherë të formoje një komisione për vlerësimin e pasurisë i cili do ta caktonte vlerën e pasurive dhe ta kompletoje regjistrin e pasurisë  
Regjistri i pasurive të përmbajë këto informata vijuese:
  - Numrin e pasurive (unikat për secilin pasuri) dhe shënimin në etiketë për çdo pasuri.
  - Përshkrimin e mjetit
  - Lokacionin e mjetit
  - Datën e përvetësimit
  - Çmimi blerës
  - Metodën e zhvlerësimit
  - Vlera neto e librit si ne fillim ashtu edhe në fund të periudhes
- b) Të përditësohet regjistri kontabël i pasurisë në “Free Balance” dhe të behet harmonizimi në mes regjistrin kontabël dhe regjistrin të pasurisë.
- c) Të kryhet në kohen e parapare me ligj inventarizimi i pasurisë për tu ditur të gjitha ndryshimet dhe vlera e sakte e pasurisë se entitetit.



## Aneksi I

### Neni 9. Raporti i Buxhetit

#### Raport buxheti

	Buxheti fillestar	Buxheti me Rishikim	Buxheti Përfundimtar	Ndryshimet	Ndryshimet	Ndryshimet
